



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01- 33129/22
Kaçanik, 16.12.2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **X (dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 20 dhjetor 2022 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Maviqe Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka, Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e X-të (dhjetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2022, data 20 dhjetor, me këtë :

REND PUNE

- 1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
- 2.Krijimi i hapësirave për parkingje; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka, A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ? Procesverballi i mbledhjes se IX-të (nëntë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2022, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se IX-të (nëntë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2022, të datës 22.11.2022 / Lënda : 01Nr. 60/01-31055/22.

2 Krijimi i hapësirave për parkingje;

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë nga ekzekutivi nuk merr pjesë askush me na dhënë sqarime të nevojshme, sidoqoftë e hapi diskutimin për këtë pikë:

znj.Arta Avdiu: Sa i përket krijimeve të parkingjeve, konsiderojë që komuna nuk ka punuar mjaftueshëm në këtë drejtim. Para dy (2) viteve komuna ka ndërtuar objektin e qerdhes duke rrënuar një objekt sportiv shumë të kushtueshëm, në këtë rast nuk e ka vlerësuar si të arsyeshme ndërtimin e një parkingu nëntokësor pasi që ky vend është shumë i përshtatshëm dhe shumë i qëlluar për një gjë të tillë. Vlen të theksohet se hapësira e oborrit të komunës shfrytëzohet vetëm për veturat zyrtare ndërsa për qytetaret të cilët vijnë për kryerjen e shërbimeve të tyre në administratë komunale, kjo hapësirë e parkingut është e pa shfrytëzueshme.

Komuna ka lëshuar një linjë ku ka rregulluar parkun përball oborrit të komunës për të ndërtuar një parking që ti përmbush sa do pak nevojat për qytetaret e komunës tonë.

Në Bulevardin Ismail Raka, komuna ka shpenzuar me qindra mijëra euro për ndërtimin shtatësor dhe nuk e pare të nevojshme që të bëjë ndryshimin në vend parkingjet që më pak lëvizje kanë veturat dhe të ju sigurohet parkingu i pjerrët dhe dukshëm të shtoheshin vendet për parkingje. Tani kemi ndërtimin e sheshit dhe aty nuk kam njohuri se a është parapare ndonjë parking, theksojë që ky është një lëshim nga komuna sepse aty ka qene me adekuate që hapësira të shfrytëzohet për parking se sa për shesh, apo se paku të ndahet një pjesë për parking duke pas parasysh nevojën kaq të madhe që ka komuna për parking.

z. Ekrem Livoreka: Drejtoria e shërbimeve publike a ka ndonjë plan për parkingje në komunën Kaçanikut?

Duke marrë parasysh që Kaçaniku ka një hapësirë të pamjaftueshme mbetokësore, është me se i nevojshëm edhe ndërtimi i parkingjeve nëntokësore. Bazuar në vlerën e vogël të buxhetit të komunës, projekti për parkingjet nëntokësore mund të realizohet përmes bashkëfinancimit me qeverinë.

z.Arben Thaqi: Problemi planit urbanistik në Kaçanik, i cili është i paraqitur në përgjithësi jo vetëm Kaçanik po krejt Kosovën. Për çdo ndërtim që zhvillohet fillimisht duhet të mendohet parkingu dhe një aktivitet fizik, në baze të banorëve me pas edhe një qendër sportive, mos të lejohet vetëm me ndërtu sepse kështu ajo vjen deri te ngufatja. Andaj duhet të parashikohen disa elemente si rritja e numrit të popullsisë, rritja e numrit të veturave edhe tjetra është se në nuk e mbrojmë ambientin, për çdo gjë shfrytëzojmë veturat ndërsa dobitë më të mëdha janë nga ecja në këmbë.

Problemi i planit urbanistik vjen kryesisht edhe nga pozita e Kaçanikut, pasi që kjo pozite është si grupë prandaj ka qenë dashtë që punimet të zhvillohen në mënyrë specifike.

3.Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:40.

Procesmbajtës
Maviqe Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

